



Përgatiti: Gen Kelmendi

“Qoftë lavdëruar nata e bekuar,

në të cilin Pejgamberit të Zotit iu shpall, nga lartë, Kur`ani

me përkryeshmërinë e tij”.

Gëte

Ajo që paraqitet këtu është një përmbledhje faktesh shkencore të cila koinsistoin me mendimin shkencor-logjikë të vënë në rediqenca nga personaliteteve më të njohur botëror, dhe figurave më eminente dhe më me ndikim në shkencën bashkëkohore.

Ky punim është shkëputje e disa fragmenteve nga libri “El-Ixhaz Ilmi fil-Kur`an” (Mrekullitë shkencore në Kur`an) të autorit Prof. Dr. Abdulmexhid Zendani.

Kjo padyshim se do t`u shërbejë edhe atyre të cilët nuk janë muslimanë, por dëshirojnë të njohin Islamin.

Këto janë debate shkencore të zhvilluar me katërmbëdhjetë (14) shkencëtarë bashkëkohorë të sferave të ndryshme.

Prof. Dr. Keeith Moore [njëri nga dijetarët më të mëdhenj në anatomi dhe embriologji, profesor në Universitetin e Torontos, në Kanada. Është autor i librit "The Developing Human, Clinically Oriented Embryology", që është përkthyer në tetë gjuhë. Ky libër (The Developing Human, Clinically Oriented Embryology) është manual shkencor që është bazë në shkencën e mjekësisë botërore. Kur në Amerikë u formua një komision për të zgjedhur librin më të mirë në botë të shkruar prej një autori, ky libër u zgjodh më i miri] thotë:

"Si është e mundur që Muhammedi para 1400 vitesh t'i përshkruajë kaq saktësisht fazat e zhvillimit të embrionit në mitrën e nënës, gjë që u zbulua nga shkenca bashkëkohore, vetëm para 30 vitesh?!"

Jam plotësisht i bindur, se këto fakte, Muhammedit i kanë ardhur nga Zoti, sepse këto informacione shkencore, shkenca i zbuloi kohët e fundit pas një pune shumë të lodhshme. Dhe ky është fakt bindës për mua, se Muhammedi është i dërguari i Zotit.

Pra, dijetarët botërorë në kohën tonë, janë në gjendje të provojnë se ky libër është zbritur nga Allahu. Dhe unë nuk gjej ndonjë vështirësi që ta pranoj këtë.

Besoj se erdhi koha të deklaroj se: S'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij

Për mua është e qartë se këto thënie i kanë ardhur Muhamedit nga Zoti, sepse pothuajse e gjithë ajo njohuri nuk është zbuluar deri shumë shekuj më vonë. Kjo ma vërteton mua se Muhamedi duhet të jetë i Dërguar i Zotit".

Prof. Taxhatan Taxhasun [përgjegjës i anatomisë dhe embriologjisë në universitetin Shajng Maj në Tajlandë dhe njëherësh është dekan i fakultetit të mjekësisë në këtë universitet] thotë:

"Unë besoj vërtetë se çdo gjë që është përmendur në Kur'an para 1400 vjetësh është e vërtetë e qëndrueshme dhe mund të shpjegohet përmes shkencës. Pejgamberi Muhammed s'dinte të shkruante dhe të lexonte. S'ka dyshim se ai është i dërguari i Zotit, i cili na solli të vërtetën Kjo e vërtetë atij iu dha përmes shpalljes nga Krijuesi, Gjithënjohësi i çdo gjëje. Ky Krijues s'ka dyshim se është Allahu.

Prandaj besoj se erdhi koha që të deklaroj se: "S'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij".

Prof. Dr. Alfred Kroneri [një ndër shkencëtarët më të njohur të gjeologjisë] thotë:

"Duke menduar më thellë rreth këtyre çështjeve dhe rreth asaj se nga i mori Muhammedi ato njohuri, kur dihet se ai ishte beduin dhe analfabet, besoj se është e pamundur që vet ai, të mund të sillte njohuri kaq të sakta mbi gjithësinë dhe krijimin e saj. Kto njohuri shkenëctarët i zbuluan vetëm para disa vitesh me anën e mjeteve të sofistikuara bashkëkohore".

Prof. Dr. MARSHALL XHONSON [përgjegjës i Katedrës së anatomisë dhe drejtor i institutit "DANIEL", në universitetin "TOMAS XHEFERSON" në Filadelfia të SHBA-së] thotë:

"Unë si shkencëtar mund të merrem vetëm me gjëra që mund t'i shoh saktësisht, mund të kuptoj embriologjinë, zhvillimin e biologjisë, mund të kuptoj fjalët, të cilat më përkthehen nga Kur'ani...

Sikur unë të imagjinoj që të jetoj në atë kohë me këto dije që kam mësuar deri më sot, s'do t'i përshkruaja gjërat ashtu siç janë përshkruar në Kur'an. Unë nuk shoh se ka ndonjë shkas apo fakt i cili tregon, se Muhammedi a.s. zotëronte ndonjë mjet, i cili ia mundësoi marrjen e këtyre njohurive nga ndonjë vend. Për këtë arsye nuk shoh asgjë, që e bën të pamundur të kuptoj se ishte frymëzim ose SHPALLJE HYJNORE, të cilën ai arriti ta transmetojë."

Prof Jushjudi Kozan [drejtor i Institutit Astronomik në Tokio] thotë:

"Jam i impresionuar shumë me zbulimin e së vërtetës në Kur'an, para nesh astronomët u morën me studimin e pjesëve të kufizuara në qiell, kurse ne jemi përqendruar në të kuptuarit e këtyre pjesëve, sepse nëpërmjet teleskopit ne mund t'i shohim të gjithë pjesët kryesore në qiell e gjithashtu nëpërmjet të lexuarit të Kur'anit marrim edhe përgjigjen e pyetjeve. Besoj se unë mund ta gjej rrugën time të ardhshme për studimin e universit."

"Vërtet Kur'ani e përshkruan universin nga pika më e lartë e ekzistencës. Çdo gjë para tij është e hapur. Ai prej të cilit ka ardhur Kur'ani e sheh çdo gjë në univers. Asgjë s'është e fshehur për Të."

Prof. Dr. Xhuli Samsun [profesor i gjinekologjisë në Universitetin North Western, në Çikago të SHBA-së] thotë:

"Unë besoj se s'ka kundërshtim mes njohurive shkencore dhe shpalljes islame. Islami i përkrah dhe i nxit metodat shkencore. Shpallja Kur'anore, e cila iu zbulua Muhammedit a.s., para 1400 vjetësh aludon në të vërtetat shkencore rreth të cilave diskutohet në simpoziumet dhe tribunat e ndryshme shkencore. Kjo dëshmon se: KUR'ANI ËSHTË FJALË E ALLAHUT".

Prof. Haji [ndër shkencëtarët më të njohur të oqeanologjisë në Amerikë] thotë:

"Jam shumë i impresionuar që gjinden të tilla dije në Kur'anin famëlartë. S'mund ta di se nga kanë ardhur ato. Është shumë interesante që këto vargje shkencore gjenden në Kur'an dhe vazhdimisht po punohet në zbulimin e domethënieve të vargjeve të tij. Besoj se vërtetë këto janë prej Zotit"

Prof. Dr. Parsani [përgjegjës i anatomisë në fakultetin e mjekësisë në Kanada, autor i njohur, ka shkruar disa libra shkencorë. Besa Osmanaj fushën e gjinekologjisë] thotë:

"Më kanë shpjeguar se Muhammedi ishte njeri i zakonshëm dhe nuk dinte shkrim e lexim. Ai jetoj para më shumë se 1400 vjetësh, ishte analfabet e dha sqarime dhe shpjegime të thella dhe të detajuara (hollësishme) që çuditërisht përputhen me shkencën."

Unë personalisht nuk mund të them se kjo u bë rastësisht. Ka shumë gjëra që janë përmendur saktësisht. Prandaj, sikurse doktor Keith Moore [Profesor Emeritus i anatomisë dhe biologjisë qelizore pranë Universitetit të Torontos, Kanada] edhe unë s'e kam të vështirë që të pranoj me

logjikën time se Kur`ani është frymëzim ose SHPALLJE HYJNORE që i është dhënë Muhammedit a.s për sqarimin e çështjeve”.

Prof. Balmar [njëri prej shkencëtarëve më të njohur të gjeologjisë në SHBA. Ishte kryetar i shoqatës, e cila organizoi kremtimin e 100-vjetorit të Shoqatës Gjeologjike Amerikane] thotë:

"Unë nuk e di se në ç`shkallë kulturore ishin njerëzit që jetonin në kohën e Muhammedit a.s., nuk e njoh as nivelin e tyre shkencor. Nëse gjendja ishte ashtu si edhe tek popujt e tjerë ku njohuritë ishin në një shkallë shumë të ulët, ku s'kishin mundësitë e sotme, s'ka dyshim se këto njohuri të cilat ne i lexojmë sot në Kur'an janë DRITË nga DIJA e ALLAHUT, të cilin Allahu ia shpalli Muhammedit a.s. ".

"Jam marrë me studimin e historisë së hershme të Lindjes së Mesme dhe nuk kam hasur të dhëna të tilla dhe përderisa në atë kohë s'kishte kësaj të dhëna, ky fakt na forcon bindjen se Allahu nëpërmjet Muhammedit dërgoi pak dije nga dija e Vet, të cilën t e fundit po e zbulon shkenca moderne. Ne do të vazhdojmë të merremi me aspektin gjeologjik në Kur'an."

Profesor SUAVEJ [një ndër dijetarët më të shquar të gjeologjisë dhe hidrologjisë në Japoni. Ai, po ashtu, është një ndër shkencëtarët më në zë në botë] thotë:

"Më duket shumë misterioze, shumë. Madje gati e pamundshme që të besoj si të vërtetë atë që thuhet (për Kuranin). Vërtetë Kur`ani meriton vëmendje dhe kujdes. Unë pajtohem rreth kësaj".

Prof. Dr. Armstrong [njëri nga shkencëtarët më të njohur të astronomisë në SHBA, gjithashtu punon në agjencinë e fluturimeve kozmike "NASA", dhe është edhe profesor i Astronomisë në Universitetin e Kansas, Lawrence, Kansas, SHBA] thotë:

"Unë jam shumë i impresionuar, se si ky libër përputhet plotësisht me astronominë bashkëkohore, gjë që zgjon kureshtjen e shkencëtarëve. Nuk kam dije të mjaftueshme rreth historisë së njerëzimit aq sa të imagjinoj periudhën e para 1400 vjetëve. Por dua të them se ajo që thuhet në Kur'an është vërtetë shumë interesante. Është e pamundur që ato të jenë rezultat i të dhënave shkencore të asaj kohe".

XH. S. Gorenger [profesor në fakultetin e mjekësisë, dega e anatomisë, në universitetin Xhorxh Taun, në Uashington] duke trajtuar tezen e etapave historike të embriologjisë të faktit se njeriu zhvillohet në disa periudha, e cila u zbulua në shek. e 19-të dhe u konfirmuan në fillim të shek. 20-të, ai në simpoziumin e 8-të të mjekësisë në Arabinë Saudite. foli mbi periodat e përmendura në Kur'an dhe mosnjohjen e tyre nga njerëzit deri në kohën e sotme, mbi përshkrimin e saktë dhe konciz të bërë në Kur'an me fjalë që çuditërisht përputhen me shkencën e sotme. Duke folur mbi këtë çështje **prof. Gorenger** thotë:

"Ky është përshkrim që i është bërë zhvillimit të njeriut që nga fillimi e derisa tek ai formohen gjymtyrët, në brendësi të mitrës së nënës. Ky përshkrim dhe këto sqarime të qarta dhe përmbledhëse të çdo periode, nëpër të cilën kalon embrioni për nga vjetërsia i përket shekujve para se të bëhej përshkrimi i periodave të ndryshme të embrionit e që është përmendur nga dijet tradicionale".

Prof. Dr. Derga Bursad Rav [profesor i oqeanologjisë] thotë:

"Është vështirë të imagjinohet se këto njohuri (që gjenden në Kur'an) kanë ekzistuar në atë kohë, pra para 14 shekujsh. Edhe pse disa gjëra përfshijnë mendime të përgjithshme, përshtatimi i disa detajeve në hollësi është gjë shumë e vështirë. Nga kjo kuptohet se kjo s'është dije njerëzore, sepse njeriu i zakonshëm s'ka mundësi t'i shpjegojë këto fenomene me kaq përpikëri. Kjo më shtyn të mendoj për një Fuqi Mbinatyrore e Mbinjerëzore dhe më bën të besoj se këto njohuri kanë ardhur nga një burim Hyjnor".

Prof. Shruvejder [një ndër shkencëtarët e oqeanologjisë në (ish) Gjermaninë Perëndimore] gjatë një simpoziumi të organizuar nga Universiteti mbretëror Abdul Azis në Xhide të Arabisë Saudite, tha:

"Shkencëtarët mendojnë se përparimi i shkencës ka hedhur dyshim rreth doktrineve fetare. Prandaj feja duhet t'i nënshtrohet shkencës. Ne këtu kemi të bëjmë me një qëndrim krejt tjetër. E vërteta e Kur'anit po zbulohet sot nga shkencëtarët bashkëkohorë. Unë jam i bindur se është me rëndësi që ky simpozium, këtë të vërtetë t'ua transmetojë shkencëtarëve dhe dijetarëve të të gjithë popujve.

Unë jam i bindur se të gjithë pas këtij simpoziumi do të kthehemi duke menduar më shumë rreth lidhshmërisë që ekziston mes oqeanologjisë dhe Kur'anit."

"Rezultatet e një dijetari-shkencëtar nuk janë shpëputur nga ato, të shkencëtarëve të tjerë. Nuk mund të jetë shkenca në një anë dhe feja në anën tjetër. Të gjithë ata ecin në një drejtim. Ato thonë të njëjtën gjë edhe pse në gjuhë të ndryshme, si me gjuhë të lartë shkencore, me gjuhë të rëndomtë, ose me gjuhën e shenjave".

.....

Këto dëshmojnë se Islami porosit dhe urdhëron përvetësimin e dijes dhe se shpallja hyjnore nuk mund të bie ndesh kurrësi me të vërtetat e pakontestueshme shkencore. Shkencëtarët me të cilët i zhvilluam këto debate, nuk i përkasin besimit islam. Fakti se këta dijetarë të mëdhenj, në fushat përkatëse, e pranojnë këtë, është argument i fortë nxitës për shkencëtarët tjerë të të njëjtit nivel, e aq më tepër për ata njerëz që qëndrojnë më poshtë sa i përket nivelit të tyre shkencor. S'ka dyshim se këta, u hapin atyre dyert e mbyllura dhe i drejtojnë në rrugën drejt besimit tek Allahu, Zotit të botëve.

Ne nuk kërkojmë gjë tjetër, veçse të përmirësojmë, me aq sa kemi mundësi, gjë që mund ta arrijmë vetëm me ndihmën e Allahut xh.sh. atij i mbështetemi, tek Ai do të kthehemi dhe vetëm Ai është i denjë për çdo falënderim.

S'ka rrugëdalje tjetër për njerëzimin veçse të pranoj atë që pranuan këta dijetarë. Më të vërtetë, Allahu i Madhëruar ia shpalli Muhammedit a.s. Kur'anin me dijen e Tij dhe i premtoi njerëzimit se gjatë zhvillimit të tyre do të zbulojnë atë që do të vërtetoj se Kur'ani është libër i Zotit, ashtu si thotë Allahu i Madhëruar:

Allahu thotë në Kur'anin Famëlartë:

“Çdo lajm e ka afatin e realizimit e më. vonë ju do ta kaptoni” (Enam, 67)

"E ju gjithsesi, më vonë do ta kuptoni vërtetësinë e Kur'anit." (Sad, 88)

"Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin shenjat Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se Kur`ani është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" (Fussilet, 53)

"A nuk shikojnë ata me vëmendje qiellin, se si mbi ta kemi ndërtuar atë dhe e kemi zbukuruar, duke mos pasur në të ndonjë plasaritje". (Kaf, 6)

“... Drejto shikimin (në drejtim të qiellit) se a sheh ndonjë çarje. Mandej, herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet te ti i përulur dhe i molisur". (Mulk, 3-4)

“E atyre që u është dhënë dija, e dinë se kio që të është shpallur nga Zoti yt është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e të Gjithëfuqishmit dhe të Lavdëruatit" (Sebe, 6)